

## Gjuhë gjermane V

| Informatat themelore për lëndën |  |
|---------------------------------|--|
| Njësia akademike:               | <b>Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane</b>   |
| Titulli i lëndës:               | <b>Gjuhë gjermane V</b>  |
| Niveli:                         | <b>BA</b>  |
| Statusi i lëndës:               | <b>Obligative</b>  |
| Viti i studimeve:               | <b>viti i III semestri i V</b>   |
| Numri i orëve në javë:          | <b>2 + 2</b>   |
| Kreditë ECTS:                   | <b>6 ECTS</b>  |
| Koha / Vendi:                   | <b>Sipas orarit</b>  |
| Mësimdhënësi:                   | <b>Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hamiti</b>  |
| Të dhënat kontaktuese:          | <b>vjosa.hamiti@uni-pr.edu</b>   |
| Përshkrimi i lëndës:            | <p>Në vazhdimësi të lëndës <i>Gjuhë gjermane IV</i>, kjo lëndë synon zhvillimin e mëtejshëm të shkathtësive komunikative dhe sociale në gjuhën gjermane, duke përfshirë të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit. Studentët do të përvetësojnë njohuri të reja mbi strukturën e gjuhës dhe do të sensibilizohen për dimensionet ndërkulturore të komunikimit.</p> <p>Në kuadër të ligjëratave dhe ushtrimeve, trajtohen struktura gramatikore të nivelit C1 dhe ushtrohen shkathtësitë produktive (të shkruarit dhe të folurit, me fokus te tiparet e teksteve të ndryshme) dhe ato receptive (të lexuarit dhe të dëgjuarit). Strategjitë e leximit global, selektiv dhe të detajuar do të aplikohen në mënyrë të rregullt, ndërsa fjalori i studentëve do të pasurohet me shprehje dhe konstrukte komplekse tipike të nivelit C1.</p> <p>Përveç librit bazë, mësimi do të mbështetet edhe në tekste autentike që lidhen me përditshmërinë, në gramatika të gjermanishtes për të huaj si dhe në materiale audio (CD) për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit. Kështu, studentët do të zhvillojnë kompetencë të gjithanshme gjuhësore, duke e përdorur gjermanishten në mënyrë funksionale dhe kontekstuale.</p> |

Qëllimet e lëndës:

Kjo lëndë synon:

- zhvillimin e shkathtësive receptive dhe produktive të studentëve në nivelin C1 sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (CEFR);
- t'u mundësojë studentëve të bëhen përdorues efikasë dhe fleksibilë të gjuhës gjermane si për qëllime personale, ashtu edhe profesionale;
- të rrisë vetëbesimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me folës burimorë dhe jo-burimorë të gjermanishtes;
- të zhvillojë shkathtësitë studimore dhe strategjitë për të nxënë gjuhën;
- t'i aftësojë studentët të integrojnë gjuhën me shkathtësitë reale jetësore;
- të inkurajojë mësim-nxënien e pavarur.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:

- komunikojnë me folës burimorë dhe jo-burimorë të gjermanishtes, me gojë dhe me shkrim, me vetëbesim, saktësi dhe rrjedhshmëri në nivelin C1 të CEFR-it;
- hartojnë dhe strukturojnë lloje të ndryshme tekstesh akademike, profesionale dhe praktike;
- përdorin shkathtësitë ndërpersonale në kontekste të ndryshme kulturore e profesionale;
- zbatojnë mendimin kritik dhe analitik në situata të ndryshme komunikimi dhe mësimi.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

| Aktiviteti                      | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---------------------------------|--------------|-----------|----------|
| Ligjëratat                      | 2            | 15        | 22.5     |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | 4            | 15        | 45       |
| Punë praktike                   |              |           |          |
| Përgatitje për test intermediar | 2            | 5         | 10       |
| Konsultime me mësimdhënësin     | 15 min       | 15        | 4        |
| Puna në terren                  |              |           |          |

|   |   |    |                                   |
|---|---|----|-----------------------------------|
| Testi, punimi i seminarit                       |   |    |                                   |
| Detyrë shtëpie                                  | 2 | 15 | 30                                |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 15 | 30                                |
| Përgatitja për provimin final                   | 5 | 2  | 10                                |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 2 | 2  | 4                                 |
| Projektet, prezantimet, etj.                    |   |    |                                   |
| <b>Total</b>                                    |   |    | <b>145.5 : 25=5.82<br/>6 ECTS</b> |

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi realizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve, duke kombinuar metoda të ndryshme me qasje komunikative dhe ndërkulturore, me qëllim përmirësimin e shkathtësive receptive dhe produktive gjuhësore. Metoda bashkëbiseduese përdoret në punë individuale, në çifte dhe në grupe. Në pjesën teorike trajtohen elemente të strukturës gramatikore të gjermanishtes që shërbejnë për realizimin e komunikimit. Studentët pritet të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, të angazhohen vazhdimisht me detyra të shtëpisë dhe të punojnë në mënyrë të pavarur gjatë gjithë semestrit.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.  
Vijueshmëria e studentit 10%;  
Detyrat individuale të kryera në klasë dhe shtëpi 10 %;  
Kollokfiumi I 40%  
Kollokfiumi II 40%

**Literatura primare:**

**Ligjerata:**

1. DUDEN 4 (2022): Die Grammatik. Mannheim. Wien. Zürich. Leipzig.
2. Helbig/Buscha (2013): Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht. Leipzig.
3. Hentschel, Elke/ Weydt, Harald (2013): Handbuch der deutschen Grammatik, Berlin
4. Karin Hall/Barbara Schneider (2013): Übungsgrammatik für Fortgeschrittene DaF.
5. Karin Hall/Barbara Schneider (2018). Deutsch als Fremdsprache: Übungsgrammatik für die Oberstufe. Hueber Verlag.

**Ushtrime:**

6. Sander, I., Schmeiser, D., Braun, B., Fügert, N., Jin, F., Mautsch, K. F., & Wiebel, A. (2024). Kompass DaF C1.1: Deutsch für Studium und Beruf: Kurs- und Übungsbuch mit Audios und Videos. Publisher.

|                    |   |
|--------------------|---|
|                    | <p>7. Dreyer/Schmitt (2013): Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik, Neubearbeitung, Lehr- und Übungsbuch: 'Die neue Gelbe'. Neubearbeitung. Ismaning/München.</p> <p>8. Helbig/Buscha (2006): Übungsgrammatik. Leipzig.</p>  |
| Literatura shtesë: | <p>1. Habermann, Mechtild / Diewald, Gabriele/ Thurnaur, Maria (2009) : DUDEN - Fit für das Bachelorstudium: Grundwissen Grammatik für Sprachstudiengänge</p> <p>2. Zifonun,G/ Hoffmann,L / Stecker, B. , (1997): Grammatik der deutschen Sprache ,1, 2, 3 , Berlin/New York,</p> <p>3. Eisenberg, Peter(2013): Grundriss der deutschen Grammatik/Das Wort, Stuttgart</p> <p>4. Eisenberg, Peter(2013): Grundriss der deutschen Grammatik/Der Satz, Stuttgart</p> <p>5. Engel, Ulrich (2004): Deutsche Grammatik, München Ismaning/München.</p> |

| <b>Hartimi i planit mësimor</b> |  |
|---------------------------------|--|
| <b>Java</b>                     | <b>Titulli i ligjëratës</b>  |
| Java 1:                         | Einführung in die Lehrveranstaltung  |
| Java 2:                         | <b><u>Perfekt mit haben oder sein</u></b><br>-Verben der Fortbewegung  |
| Java 3:                         | <b><u>Perfekt mit haben oder sein</u></b><br>-Verben der Zustandsveränderung   |
| Java 4:                         | <b><u>Transitive und intransitive Verben</u></b><br>-Transitive und intransitive Verben mit gleicher Bedeutung                                 |
| Java 5:                         | <b><u>Transitive und intransitive Verben</u></b><br>-Transitive schwache und intransitive starke Verben  |
| Java 6:                         | <b><u>Untrennbare und trennbare Verben</u></b><br>-Verben mit untrennbaren, unbetonten Vorsilben<br>-Verben mit trennbaren, betonten Vorsilben |
| Java 7:                         | <b><u>Untrennbare und trennbare Verben</u></b><br>-Verben mit mehreren Vorsilben   |
| Java 8:                         | <b>Kollokfiumi I</b>   |
| Java 9:                         | <b><u>Passiv</u></b><br>-Der Gebrauch des Passivs  |
| Java 10:                        | <b><u>Passiv</u></b><br>- Passivfähigkeit  |

|          |   |
|----------|---|
| Java 11: | <b><u>Passiv</u></b><br>-Das Vorgangspassiv   |
| Java 12: | <b><u>Passiv</u></b><br>-Das Zustandspassiv   |
| Java 13: | <b><u>Passivumschreibungen</u></b><br>-Der Gebrauch der Passivumschreibungen<br>-Passivumschreibungen mit Modalfaktor |
| Java 14: | <b><u>Passivumschreibungen</u></b><br>-Passivumschreibungen ohne Modalfaktor  |
| Java 15: | <b><u>Kollokfiumi II</u></b>  |

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet rregullisht. Lejohen maksimumi **tri mungesa gjatë semestrit**; tejkalimi i këtij kufiri ndikon në pjesëmarrjen dhe vlerësimin final. Detyrat që dalin nga orët e mësimit janë të detyrueshme dhe përbëjnë pjesë integrale të vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime apo në punimet me shkrim ndalohen rreptësisht dhe trajtohen si shkelje serioze akademike. Në raste të tilla, studenti i nënshtrohet masave disiplinore sipas rregulloreve në fuqi të Universitetit të Prishtinës.

